



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 465 prot.

Himarë, më 27.01.2023

VENDIM

Nr. 1 datë, 27.01.2023

PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE DHE KUJDESIT SHOQËROR
Nga fondet e Bashkisë

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të pikës 5, të nenit 15, dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr.121 datë 21.11.2016 ‘‘Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Në mbështetje të vendimit Nr. 518 datë 4.9.2018 Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar. Në mbështetje të V.K.M 518 datë 4.9.2018 kreu II pika b) ku përfshihet shërbimi në familje. pika 4, Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe për persona që janë me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe mund të ndihmohen nga kujdestari apo ndihmësi personal; Sipas projektvendimit të paraqitur nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për vendosjen e ndihmësit personal për familjet me nevoja ekstreme nga fondet e buxhetit vendor Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës **27.01.2023**.

VENDOSI

Për caktimin e shërbimit në shtëpi (kujdestar ligjor), sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të Vendimit 518 date 04.09.2018, për zonjën Marjana Godo Xhaferi e datëlindjes 04.02.1965 me nr ID G55204135B banore në fshatin Sasaj, e cila ka probleme mendore është shtruar disa herë në spitalin psiqiatrik Vlorë, nuk është në gjëndje për të shërbyer vetes dhe është e braktisur nga familjarët. Për familjen e Blerina Nexhip Dervishi banore në fshatin Qazim Pali Nj. Administrative Lukovë përfituese e statusit të para-tetraplegjikut e cila është në kujdestarinë e nënës së saj Znj. Bihe Dervishi e cila është e mushuar dhe me probleme të rënda shëndetësore. Në pamundësi për të shërbyer vajzës së saj Blerinës dhe bashkëshortit të saj Nexhip Dervishit i cili është në moshë madhore me probleme shëndetësore të rënda, ku nuk ka mundësi të lëvizë dhe të shërbejë

vetes i këkoj mbështetje financiare Bashkisë për të vendosur një kujdestar ligjor për vajzën Blerina Dervishi.

-Masa e përfitimit të kujdestarëve ligjor të jetë në shumën 10.000 lekë në muaj. Kjo shumë duhet të jepet për periudhën **1 Janar – 31 Dhjetor 2023** dhe do të përdoret fondi nga buxheti i Bashkisë. Ngarkohet administrata e Bashkisë.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Elena Memushaj



KRYETARI I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj

